

Vendim nr. 86 datë 26.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 26.04.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 4 (E) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: ELONA LILA, përfaqësuar nga avokat Altin Gjata, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 3880, datë 16.11.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-4493, datë 07.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27-31 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja ka filluar punë në Shërbimin Social Shtetëror (*SHSSH*) në datën 20.01.2011 në Qendrën Polivalente Ditore Kamëz. Me urdhrin e drejtorit të përgjithshëm të SHSSH-së, në datën 15.03.2013, ajo është emëruar në detyrën e përgjegjëses së sektorit të administratës në Shtëpinë e Foshnjës Tiranë dhe më pas si përgjegjëse e sektorit të financës.

2. Bazuar në ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, sektori i Auditit të Brendshëm të Shtëpisë së Foshnjës Tiranë ka ushtruar kontroll në këtë institucion për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2013, në përfundim të të cilit, përmes raportit final të auditimit, janë konstatuar shkelje në ushtrimin e detyrës nga kërkuesja. Për këtë shkak, me shkresën nr. 693 prot., datë 26.03.2014 “Njoftim për paraqitje në takim” të drejtorit të përgjithshëm të SHSSH-së, kërkuesja është njoftuar për fillimin e procedurave të ndërprerjes së marrëdhënieve të saj të punës, si dhe për t’u paraqitur në takimin e datës 31.03.2014 me drejtorin e përgjithshëm, ku ajo kishte të drejtën të shprehej. Në vijim, me urdhrin nr. 693/2, datë 02.04.2014, drejtori i përgjithshëm i SHSSH-së ka vendosur lirimin e kërkueses nga detyra, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimin e ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Marrëdhëniet e punës së kërkueses janë ndërprerë në datën 03.04.2014.

3. Duke mos qenë dakord me veprimet e SHSSH-së për zgjidhjen e kontratës së punës, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar detyrimin e SHSSH-së t’i paguajë si dëmshpërblim pagën e 1 viti, për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës; pagën e 2 muajve, për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit; pagën e 2 muajve, për shkak të mosrespektimit të procedurës së largimit; dëmshpërblimin për vjetërsinë në punë, me pagë 15-ditëshe për çdo ditë vjetërsie në punë.

4. Me vendimin nr. 5165, datë 29.09.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë; detyrimin e palëve të paditura t’i paguajnë kërkueses 2 muaj pagë, si dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës pa respektuar afatin e njoftimit; 10 muaj pagë për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar; 1.5 muaj pagë si shpërblim për vjetërsi në punë; rrëzimin e padisë për sa u përket kërkimeve të tjera. Sipas gjykatës, përfundimet e kontrollit të auditimit nuk i ishin komunikuar kërkueses dhe ajo nuk kishte paraqitur observacione në lidhje me to. Po kështu, palët e paditura nuk kishin arritur të provonin se cilat detyrime kontraktuale nuk kishte përmbushur kërkuesja ose fajin e saj dhe, nisur nga periudha e audituar e lloji i institucionit të audituar, përgjegjësit për shkeljet e mundshme të konstatuara ishin titullarët e këtij institucioni dhe përgjegjësit e financës, që kishin përpiluar situacionet financiare. Për rrjedhojë, në rastin e

kërkueses, nuk rezultonin të provuara kushtet kumulative për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të justifikuar.

5. Për ankimin e paraqitur nga SHSSH-ja, me vendimin nr. 3880, datë 16.11.2016, Gjykata Administrative e Apelit, në dhomën e këshillimit, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se zgjidhja e kontratës së punës ishte kryer për shkaqe të justifikuara, në këndvështrim të nenit 153 të Kodit të Punës (KP), pasi raporti final i auditimit kishte konstatuar shkelje gjatë ushtrimit të detyrës nga kërkuesja, si përgjegjëse e sektorit të financës, për rrjedhojë për ligjëz zgjidhja e menjëhershme e saj.

6. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit kërkuesja ka ushtruar rekurs, duke pretenduar se kjo gjykatë kishte bërë interpretim të gabuar të fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe të nenit 153 të KP-së. Sipas saj, në ankimin e SHSSH-së nuk ishin paraqitur prova të reja thelbësore që çonin Gjykatën Administrative të Apelit në një vendimmarrje në dhomën e këshillimit të kundërt nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë. Po kështu, duke pasur parasysh raportin e auditimit dhe rekomandimet përkatëse, në mënyrë që të bënte një vlerësim të drejtë të çështjes, gjykata e apelit duhej ta kishte shqyrtuar atë në seancë gjyqësore.

7. Me vendimin nr. 00-2023-4493, datë 07.11.2023, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, duke vlerësuar se përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative e Apelit ishte rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural. Kështu, sipas Kolegjit Administrativ, ishte detyrë e saj të parashtronte qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore, duke argumentuar se përse gjykata kishte zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin material ose procedural, si dhe cilat ishin ato shkelje të rënda procedurale që ndikonin dukshëm në dhënien e vendimit. Në rastin e saj, gjykatat më të ulëta kishin zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, sipas nenit 14 të Kodit të Procedurës Penale (KPC). Ato kishin bërë cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve, si dhe analizë të hollësishme dispozitave të KP-së, që rregullonin mosmarrëveshjen në gjykim. Po kështu, në rekurs nuk ngriheshin pretendime se vendimi binte ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ ose vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe as për shkelje të rëndë të normave procedurale. Nga ana tjetër, pjesa e pretendimeve në rekurs që ngrinte çështje të vlerësimit të provave dilte jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

8. Në datën 05.03.2024 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkuësjes

9. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

9.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit*, pasi shqyrtimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit është bërë në dhomën e këshillimit. Në kushtet kur gjykata e apelit është gjykatë fakti, shqyrtimi nga kjo gjykatë i çështjes duhej të ishte bërë në seancë gjyqësore. Nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), që lejojnë gjykatën e apelit të gjykojë në dhomën e këshillimit, janë antikushtetuese. Po kështu, edhe rekursi i saj është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit.

9.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi:

9.2.1. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar për provat pa ia nënshtuar ato debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike, ku palët të mund të jepnin argumentet e tyre, të paraqisnin argumente shtesë ose prova të tjera në dobi të procesit.

9.2.2. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të saj për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, si rrjedhojë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit në dhomën e këshillimit. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë se është detyrë e rekursuesit të parashtojë qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore, duke argumentuar zbatimin e gabuar nga gjykata të ligjit material e procedural, pasi nëse këto shkaqe nuk parashtrohen dhe argumentohen sipas kërkesave të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, kjo gjykatë është e detyruar të vendosë mospranimin e rekursit, i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor. Po kështu, vlerësimi i Gjykatës së Lartë se rekursi i saj nuk përmbante shkaqe për shqyrtimin e

çështjes në seancë gjyqësore, nuk justifikon mospranimin e tij me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe ligjore nga ato që e vënë në lëvizje si gjykatë.

- 9.3. *Standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*, pasi rekursi ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit është paraqitur në vitin 2016, ndërsa vendimi për çështjen është marrë nga Gjykata e Lartë në nëntor të vitit 2023.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se ndonëse objekt i ankimit kushtetues individual janë vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë, në thelb, kërkuësja ka pretenduar edhe antikushtetueshmërinë e neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 49/2012, për shkak të gjykimit të çështjes së saj nga Gjykata Administrative e Apelit në dhomën e këshillimit.

12. Për sa u përket pretendimeve në lidhje me procesin gjyqësor të zhvilluar nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë, kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në këtë proces dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive

për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Kolegji vëren se pretendimin për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kërkuesja e ka parashtruar drejtpërsëdrejti përpara Gjykatës, pa shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së, përpara se t'i drejtohen Gjykatës. Për sa u përket pretendimeve të tjera, vlerësohet se ajo e ka plotësuar kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë ka përmbyllur procesin gjyqësor për lirim të saj nga detyra. Në këto kushte, ajo nuk ka më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e të drejtave që pretendon se i janë cenuar.

15. Në drejtim të legjitimitetit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji konstaton se vendimi më i fundit në kohë të kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 07.11.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 05.03.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae* kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar e parimit të kontradiktoritetit, si dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

17. Sipas kërkueses, Gjykata Administrative e Apelit ka arsytuar për provat, pa ia nënshtruar ato debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike, ku palët të mund të jepnin argumentet e tyre, të paraqisnin argumente shitesë ose prova të tjera në dobi të procesit. Për sa i përket këtij pretendimi, Kolegji vëren se ai ka të bëjë, në thelb, me gjykimin e çështjes nga kjo gjykatë në dhomën e këshillimit, për rrjedhojë me të drejtën për t'u dëgjuar. Në lidhje me pretendimin e kërkueses se Gjykata Administrative e Apelit i ka cenuar të drejtën për të paraqitur prova të tjera në dobi të procesit, Kolegji thekson se neni 47 i ligjit nr. 49/2012 nuk lejon paraqitjen gjatë gjykimit në apel të fakteve të reja ose kërkimin e provave të reja, me

përrjashtim të rasteve kur ankuesi provon se, pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj. Në rastin konkret, në ankimin kushtetues individual kërkuesja nuk përcaktuar prova konkrete, të cilat ka qenë në pamundësi t'i paraqesë gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për rrjedhojë vlerësohet se pretendimet e saj për cenimin nga Gjykata Administrative e Apelit të së drejtës për t'u dëgjuar, si rrjedhojë e pamundësisë për paraqitjen e provave të tjera gjatë procesit, nuk gjejnë mbështetje në këndvështrimin kushtetues.

18. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar edhe nga Gjykata e Lartë, si rrjedhojë e shqyrtimit të rekursit të saj nga kjo gjykatë në dhomën e këshillimit. Kolegji vëren se neni 61, pika 1, i ligjit nr. 49/2012 parashikon se shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit. Në kushtet kur Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje përmes rekursit të ushtruar nga kërkuesja, në të cilin ajo ka parashtruar argumentet e saj për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe subjektet e paditura në gjykim, SHSSH-ja dhe Drejtoria e Shërbimit të Brendshëm, nuk rezulton të kenë paraqitur kundërrkurs, Kolegji vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të argumentojë në këndvështrimin kushtetues cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit, për shkak të shqyrtimit të rekursit të saj në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë.

19. Po kështu, për sa i përket arsytimit të Gjykatës së Lartë se është detyrë e kërkueses të parashtojë qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore, pasi nëse ato nuk parashtrohen dhe argumentohen sipas kërkesave të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, kjo gjykatë është e detyruar të vendosë mospranimin e rekursit, Kolegji çmon se kërkuesja nuk ka arritur të përcaktojë, në aspektin kushtetues, cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, për shkak të këtij arsytimi.

20. Krahas kundërshtimit të vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesja ka pretenduar edhe antikushtetutshmërinë e neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 49/2012. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se, krahas vendimit gjyqësor, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, nisur nga përmbajtja e normave kushtetuese dhe atyre ligjore, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kritere: (i) legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë

dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, Kolegji çmon se kërkuesja plotëson kriteret paraprake të legjitimitetit *ratione personae* dhe shterimit të mjeteve juridike efektive edhe në lidhje me këtë kërkim, pasi dispozitat e kundërshtuara nuk parashikojnë nxjerrjen e akteve nënligjore, ato janë zbatuar drejtpërdrejt nga Gjykata Administrative e Apelit në procesin e zhvilluar ndaj saj dhe kërkuesja e ka kundërshtuar, në thelb, përmbajtjen e tyre në rekursin drejtuar në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, ajo nuk ka më mjete në dispozicion për kundërshtimin e neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 49/2012.

22. Për sa i takon legjitimitetit *ratione temporis*, Kolegji vëren se neni 50, pika 4, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se individët mund të paraqesin kërkesë për papajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Në rastin e ankimit kushtetues individual konstatimi i cenimit, si rregull, nuk përkon me çastin e hyrjes në fuqi të ligjit ose aktit normativ, por ai llogaritet nga çasti kur akti fillon të prodhojë efekte për kërkuesin ose, e thënë ndryshe, kur ndaj tij zbatohet ligji ose akti normativ (*shih vendimin nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji evidenton se kërkuesja nuk i ka kundërshtuar dispozitat ligjore drejtpërdrejt në Gjykatë, por së bashku me vendimet gjyqësore të dhëna në zbatim të tyre, ndaj afati ligjor 4-mujor llogaritet nga data e vendimit të fundit gjyqësor. Në kushtet kur pretendimet për gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit në dhomën e këshillimit janë ngritur nga kërkuesja edhe në Gjykatën e Lartë, Kolegji vlerëson se momenti i konstatimit të cenimit për kundërshtimin e kushtetutshmërisë së neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 49/2012 përkon me datën e dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë, i cila ka përmbyllur procesin gjyqësor, për rrjedhojë kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis* për këtë pjesë të kërimit.

24. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, në kushtet kur pretendimet e kërkuesses për antikushtetutshmërinë e neneve 49 dhe 50 janë ngushtësisht të lidhura me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj saj, Kolegji vlerëson t'i trajtojë ato së bashku me pretendimet në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar dhe parimin e kontradiktoritetit.

25. Për sa më sipër, në vijim Kolegji do të trajtojë pretendimet e kërkuesses për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar e parimit të kontradiktoritetit, si rrjedhojë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit në dhomën e këshillimit, si dhe për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit

26. Kërkuessa ka pretenduar se shqyrtimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit është bërë në dhomën e këshillimit, duke i cenuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe parimin e kontradiktoritetit. Sipas saj, duke qenë se gjykata e apelit është gjykatë fakti, shqyrtimi prej saj i çështjes duhej të ishte bërë në seancë gjyqësore. Nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 49/2012, që lejojnë gjykatën e apelit të gjykojë në dhomën e këshillimit, janë antikushtetuese.

27. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Gjykata ka theksuar se elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor janë edhe e drejta e mbrojtjes edhe ajo për t'u dëgjuar. Këto dy të drejta, në unitet edhe me të drejta të tjera, kanë për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohej realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 55, datë 07.11.2023; nr. 18, datë 04.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Po sipas Gjykatës, parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. Në respektim të këtij parimi, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklaratimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih*

vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 19, datë 01.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

29. Sipas nenit 49 të ligjit nr. 49/2012 në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, me të njëjtën përmbajtje edhe sot: “1. Shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. 2. Kryetari i trupit gjykues përgatit relacionin dhe cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton palët rregullisht sipas rregullave procedural në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes të paktën 15 ditë përpara. Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim. 3. [...]”. Neni 50 i ligjit nr. 49/2012 ka përcaktuar mënyrat e disponimit të Gjykatës Administrative të Apelit në rastin e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit.

30. Në rastin konkret, nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të shqyrtimit paraprak të kërkesës, Kolegji vëren se në datën 22.10.2014 SHSSH-ja ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 5165, datë 29.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili rezulton t’i jetë komunikuar kërkueses në datën 27.10.2014. Në vijim, me vendimin e datës 21.11.2014 kryetarja e trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit ka vendosur shqyrtimin e çështjes së kërkueses në dhomën e këshillimit në datën 16.11.2016, si dhe urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për njoftimin e palëve. Në zbatim të këtij urdhri, në datën 10.10.2016, sekretaria e Gjykatës Administrative të Apelit ka afishuar listën e shpalljes së çështjeve për shqyrtim në datën 16.11.2016, ku përfshihej edhe çështja e kërkueses, përmes së cilës ajo është njoftuar edhe për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit dhe për përbërjen e trupit gjykues. Po kështu, përmes kësaj liste, palët në gjykim janë informuar për të drejtën për të paraqitur parashtrime me shkrim deri në 5 ditë përpara datës së shqyrtimit të çështjes, në zbatim të ligjit nr. 49/2012 (shih faqet 3 dhe 9 të dosjes gjyqësore të çështjes, materialet në lidhje me gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit).

31. Në analizë të këtyre akteve, Kolegji vëren se data e shqyrtimit të çështjes në seancë nga Gjykata Administrative e Apelit është caktuar pothuajse dy vjet më vonë nga data e regjistrimit të saj në këtë gjykatë. Ndërkohë, pavarësisht se në përputhje me parashikimet e nenit 49, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 kërkuësja është njoftuar nga sekretaria gjyqësore për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes në këtë gjykatë, përbërjen e trupit gjykues, si dhe për ushtrimin e së drejtës për të paraqitur parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim nga

SHSSH-ja, nuk rezulton që ajo të ketë paraqitur argumente me shkrim në zbatim të kësaj dispozite. Kolegji vëren, gjithashtu, se në ankimin kushtetues individual kërkuesja nuk ka ngritur pretendime për mosmarrjen njoftim për datën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit nga Gjykata Administrative e Apelit. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se pretendimi i saj për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit, si rrjedhojë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit në dhomën e këshillimit, është haptazi i pabazuar.

32. Për më tepër, në këtë drejtim, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë që në një shkallë gjykimi është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkueses i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe mbrojtur (*shih vendimin nr. 27, datë 18.05.2023; nr. 28, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, ndonëse çështja e kërkueses është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë, rezulton se procesi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, në të cilën kërkuesja është përfaqësuar nga përfaqësues i zgjedhur prej saj, duke iu dhënë mundësia të shprehet për pretendimet e saj për kundërshtimin e aktit të largimit të saj nga detyra, si dhe të paraqesë prova në mbështetje të këtyre pretendimeve.

33. Për sa më sipër, në rastin konkret, Kolegji vlerëson se si legjislacioni procedural, ashtu edhe Gjykata Administrative e Apelit kanë garantuar të drejtën e kërkueses për t'u dëgjuar, duke i dhënë mundësi të paraqesë argumentet e saj për çështjen në mënyrë të barabartë me palën kundërshtare, për rrjedhojë Kolegji çmon se pretendimet e saj për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit për këtë shkak, si dhe për shfuqizimin si antikushtetues të neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 49/2012, janë haptazi të pabazuara.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

34. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të saj për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, si rrjedhojë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit në dhomën e këshillimit. Po kështu, vlerësimi i Gjykatës së Lartë se rekursi i saj nuk përmbante shkaqe për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, nuk justifikon mospranimin e tij me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe ligjore nga ato që e vënë në lëvizje si gjykatë.

35. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjit të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në rastin konkret, në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë kërkuësja ka pretenduar cenimin nga Gjykata Administrative e Apelit, ndër të tjera, edhe të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar, pasi gjykimi i çështjes në këtë gjykatë është bërë në dhomën e këshillimit. Në vendimin për çështjen Gjykata e Lartë ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës Administrative e Apelit ishte rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural dhe se gjykatat më të ulëta kishin zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, sipas nenit 14 të KPC-së. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat më të ulëta kishin bërë cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve dhe analizë të hollësishme dispozitave të KP-së, që rregullonin mosmarrëveshjen në gjykim. Po kështu, në rekurs nuk ngriheshin pretendime se vendimi i gjykatës së apelit binte ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ ose vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe as për shkelje të rëndë të normave procedurale. Nga ana tjetër, pjesa e pretendimeve në rekurs që ngrinte çështje të vlerësimit të provave dilte jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih faqet 5 dhe 6 të vendimit nr. 00-2023-4493, datë 07.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

37. Në analizë të kësaj vendimmarrjeje, Kolegji vlerëson se kërkuësja ka marrë përgjigje, në thelb, edhe për pretendimet e saj për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar nga Gjykata Administrative e Apelit, për të cilat Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ato nuk kishin të bënin me shkelje të rëndë të normave procedurale, duke u shprehur në këtë mënyrë edhe për shkakun e mospranimit të rekursit në lidhje me këtë pretendim të kërkuëses. Në këtë kuptim, në kundërshtim nga sa pretendohet, në rastin konkret, Kolegji çmon se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk rezulton në cenim të standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

38. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.